

Kodra dhe Zeqir Rexhepi, e kanë bartur atë në shtëpinë e Ahmet Ahmetit, ku Rexhepi menjëherë ndërroi jetë. Trupin e tij e kanë fshehur në bodrumin e shtëpisë. Ditën tjetër, kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati, familjarët e kanë çuar trupin e Rexhepit në shtëpinë e tij në Qirez/Çirez. Në datën 3.03.1998, Rexhepin e kanë varrosur në varrezat e Likoshanit/Likošanit, së bashku me viktima të tjera që u vranë apo kanë rënë në betejë me forcat serbe në Likoshan/Likošane dhe Qirez/Çirez, më 28.02.1998.

**Burimet:** deklarata Z.R, FDH-15401; deklarata Z.R, FDH-12043; deklarata Z.R, FDH-12035; deklarata B.R, FDH-12049; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFĐUÇK, *Feniksët...3*, 87-89, FDH-24476.

### **Ahmet (Xhemajl) Ahmeti**

(30.09.1948, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, shtatë fëmijë)

### **Gani (Xhemajl) Ahmeti**

(16.02.1952, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, shtatë fëmijë)

### **Elmi (Xhemajl) Ahmeti**

(1.08.1954, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, ekonomist, pesë fëmijë)

### **Driton (Ahmet) Ahmeti**

(10.01.1975, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, dy fëmijë)

### **Naim (Ahmet) Ahmeti**

(14.09.1976, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac)

### **Shemsi (Ahmet) Ahmeti**

(1.05.1979, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

### **Lumni (Gani) Ahmeti**

(1.08.1978, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, student)

### **Basri (Gani) Ahmeti**

(10.09.1979, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllgocit/Glogovac)

### **Elhami (Gani) Ahmeti**

(20.01.1982, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

### **Hamëz (Rrustem) Ahmeti**

(25.04.1954, shqiptar nga Likoshani/Likošane, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë)

### **Behram (Rexhep) Fazliu**

(5.10.1942, shqiptar nga Gradica, komuna e Gllgocit/Glogovac, bujk, tre fëmijë)

Vëllëzërit Ahmeti, Ganiu dhe Elmiu me familjarët e tyre jetonin në një bashkësi familjare në fshatin **Likoshan/Likošane**. Familja Ahmeti i numëronte 43 anëtarë. Ahmeti, vëllai më i madh, ka qenë në krye të familjes. Ditën kritike, si mysafirë në familjen Ahmeti, rastisën të ishin axha Hamëz dhe Behram Fazliu nga fshati fqinj i Gradicës/Gradica. Prej familjarëve, mungonte vetëm djali i Ahmetit, Xhevdeti, i cili kishte shkuar në Prishtinë/Priština herët në mëngjes për të kryer disa punë lidhur me studimet.

Në datën **28.02.1998**, nga ora 11:30, kur në fshat filluan të dëgjoreshin të shtëna, anëtarët e familjes Ahmeti dhe mysafirët gjendeshin në dhomën e pritjes. Dinorja e moshuar, nëna e Ahmetit, Ganiut dhe Elmiut, si dhe gra të tjera, mundoheshin t'i bindnin burrat që të mënjanoheshin përdërisa të pushonin të shtënat, por ata refuzuan, duke konsideruar që nuk kishte arsye për një gjë të tillë. Pas orës 13:00, Xhemë Kodra, Beqir dhe Zeqir Rexhepi e sollën brenda në shtëpi Rexhep Rexhepin, pjesëtarin e UÇK-së [të shikohet regjistrimi i mëparshëm], i cili ishte i plagosur. Ai shumë shpejt dha shpirt nga plagët vdekjeprurëse. Pas pak, në oborrin e familjes Ahmeti hyri një autobлиндë e forcave serbe, pasi që e rrënoi kapinë hyrëse. Policët, të cilët ishin të veshur në uniformë të ndryshme, e kanë rrënuar derën hyrëse me kondakët dhe kanë hyrë brenda në shtëpi. Filluan t'i dëmtonin mobilet dhe t'i rrihnin burrat duke bërë pyetje "ku janë terroristët". Pastaj, i detyruan të gjithë familjarët që të dilnin jashtë në oborr. Mbi kokat e tyre fluturonin dy helikopterë nga të cilët shtënin mbi shtëpitë e fshatit. Pjesëtarët e forcave serbe u urdhëruan grave dhe fëmijëve që të shtriheshin për toke. Vazhduan t'i rrihnin burrat. Më pas, ashtu të keqtrajtuar fizikisht i nxorën jashtë oborrit dhe i rreshtuan pranë murit. Nisën